



Pranuar / Dorezuar Punëdhënësi/Prodator Received/Delivry	29.12.2021	1	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDMSHCK	6383/2021		113



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1061/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Jeton Koca dhe Arben Mehmeti-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.1029/2020 të datës 15.10.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.51/2020 të datës 25.02.2020 të parashtruar nga ankuesja me adresë rruga "Shefki Kuleta", Hyrja, Kati 5, Nr.30 në Fushë Kosovës, kundër mos zbatimit të Vendimit me Nr.03/02-44 të datës 28/01/2020 të Komisionit për Ankesa të Policisë së Kosovës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 29.12.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.51/2020 e datës 25.02.2020 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesj e punësuar në Policinë e Kosovës, më datë 25.02.2020 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 458/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 02.03.2020, ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Policia e Kosovës. Policia e Kosovës më datë 07.05.2020 ka përcjell dokumentacionin e kërkuar.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 15.05.2020 përmes Njoftimit me numër protokoll 904/2020, ka njoftuar ankuesen se nuk mund të vendos lidhur me ankesën A.nr.51/2020 të datës 25.02.2020, për shkak se Këshilli nuk ka anëtarë, duke e udhëzuar të njëjtin mbi të drejtën e inicimit të procedurës gjyqësore në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative me datë 15.10.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.1029/2020, me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses, duke anuluar njoftimin e datës 15.05.2020 të KPSHCK-se dhe ka obliguar Këshillin që në afat prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën e ankuesit A.nr.51/2020 të datës 25.02.2020.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 458/2020 të datës 25.02.2020 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.03/02-44 të datës 28.01.2020 të Komisionit për Ankesa të Policisë së Kosovës; Ankesën e ankueses të datës 30.12.2019 e parashtruar në Komision të Ankesave; E-mailin e datës 21.02.2020; Vendim për sistemim për kohë të pacaktuar i datës 03.12.2019; Konkurs i Policisë së Kosovës; E-mailin e datës 13.02.2020, 05.12.2018; Kontratë për punë për kohë të caktuar/pacaktuar datës 18.09.2014; Kartela e nëpunësit civil; Listën e pagave për ankuesen; E-mailin e datës 17.01.2020 dhe Përgjigje në ankesë e datës 07.05.2020; Njoftimin e datës 15.05.2020 dhe Aktgjykimin A.nr.1029/2020 të datës 15.10.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankueses *është e pabazuar, sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës, ankuesja është punësuar në Policinë e Kosovës në bazë të Kontratës së punës për kohë të caktuar/pacaktuar të datës 18.09.2014 në pozitën "Zyrtar i Lartë Financiar", ndërsa me Vendimin me Nr.reference 07/1-01SAP-P/10537 të datës 04.12.2019, ankuesja është sistemuar në pozitën e punës "Zyrtar i Lartë i Financave", në Drejtorinë e Personelit, po me koeficient shtatë (7) të pagës e shprehur në vlerë monetare 423.85 Euro. E pakënaqur me këtë vendim ankuesja, më datë 30.12.2019 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Ankesa të Policisë së Kosovës për kompensim të diferencës së koeficientit për tri vite në mënyrë retroaktive. Komisioni për Ankesa të Policisë së Kosovës, më datë 28.01.2020 ka nxjerr Vendim me Nr. 03/02-44 me të cilin ka aprovuar pjesërisht ankesën e ankueses duke e kthyer lëndën në rishqyrtim dhe rivendosje në Drejtorinë e Personelit.

Drejtoria e Personelit me datë 21.02.2020, ka njoftuar ankuesen se në zbatim të Vendimit të Komisionit të Ankesave ka parashtruar kërkesë në Ministrinë e Administratës Publike që të aprovoj koeficientin e pagës të njëjtë me pozitë të njëjtë në institucionet tjera të shërbimit civil, duke shtuar se derisa sa nuk ka aprovim nga kjo Ministri përgjegjëse, Policia e Kosovës nuk mund të vendos lidhur me ndryshimin e koeficientit.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës pretendon që të bëhet harmonizimin i koeficientit të pagës sipas pozitës me institucionet e tjera dhe po ashtu pretendon që Drejtoria për Personel nuk ka zbatuar vendimin e Komisionit të Ankesave.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, lidhur me pretendimet ankimore të ankueses ju referuar dispozitave të Ligji Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunëseve Civil, përkatësisht nenin 3 paragrafi 1 ku



është përcaktuar se: 1. E drejta e nëpunësve civilë për pagë të drejtë dhe të rregullt është e garantuar në bazë të kushteve të përcaktuara me këtë ligj dhe me Ligjin e Shërbimit Civil, ndërsa neni 9 paragrafi 1 i po këtij Ligji përcakton se: Nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin pagën bazë për numrin e orëve të përcaktuara me aktin e kantatës së punës, dhe rrjedhimisht konstatoj se e drejta në pagë është e drejtë themelore nga marrëdhënia e punës dhe nëpunësi civil gëzon të drejtën e realizimit të pagës të përcaktuar në aktin e themelimit të marrëdhënies së punës. Në kuptim të kësaj bazë ligjore dhe duke marrë parasysh shkresat e lëndës, Kolegji ka konstatuar se ankuesja sipas Vendimit me Nr.reference 07/1-01SAP-P/10537 të datës 04.12.2019, është sistemuar në pozitë të njëjtë ashtu siç ka qenë e emëruar me Kontratën e Punës me numër 07/1-01A/0672 të datës 18.09.2014, dhe e njëjta realizon pagën në vlerën e përcaktuar me vendimin për sistemimin e tij me kohë të pacaktuar.


Kolegji po ashtu gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se Organi i punësimit gjegjësisht Policia e Kosovës, duke ju referua dispozitave të nenit 7 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, ka bërë kërkesë pranë ministrisë përgjegjëse për administratë publike, lidhur me ngritje e koeficientit të pagës për disa pozita të punës duke përfshi edhe pozitës e ankueses, por që një kërkesë e tillë nuk është shqyrtuar nga kjo e fundit, kështu që meqenëse nuk kemi një akt me të cilën do të bëhej harmonizimi i koeficientit nga institucionet përgjegjëse relevante, atëherë Kolegji, konstaton se pretendimi për kompensim të diferencës së pagës në mënyrë retroaktive është i pa bazuar.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.


Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1061/2021

Avdyll BEKTESHI


Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-DEMI


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Policinë e Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

